

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1237 Prot.

Tiranë, më 05.122016

VENDIM Nr. 139, datë 22.11.2016

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (KKA)" (i ndryshuar), si dhe Vendimit Nr. 2, datë 30.01.2009 të KKA "Rregullore mbi Kriteret e Ushtrimit të profesionit të arkeologut; Kriteret e gërmimit, dokumentimit dhe arkivimit të të dhënave dhe materialeve arkeologjike; Kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të arkeologut nga individë dhe subjekte private", Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 13 të datës 22.11.2016, pasi shqyrtoi *Kërkesën për pajisje me licencë profesionale individuale për veprimtari arkeologjike të tipit "A1" dhe "A2" të Znj. Silvana Mema,*

VENDOSI:

1. Të miratojë *Kërkesën për pajisje me licencë profesionale individuale për veprimtari arkeologjike të tipit "A1" të Znj. Silvana Mema.*
2. Të mos miratojë *Kërkesën për pajisje me licencë profesionale individuale për veprimtari arkeologjike të tipit "A2" për arsye të mospërbushjes së pikës të nenit 13 të Rregullores së sipërpërmendur, sipas të cilës, individë duhet të jetë pajisur me "Gradë Doktor në fushën e arkeologjisë dhe nëndegët e saj brenda ose jashtë vendit, e njohur nga MASH, për rastet e gërmimeve arkeologjike me karakter studimor.*
3. Subjekti para pajisjes me dokumentin e licencës "A1", duhet të kryejë pagesën e *Tarifës së Rregjistrimit të licencës individuale të arkeologut.*
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO